Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 238-25
Tarih/Dt. 21.11.2021

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 238/25
Me 21.11.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.69/25 e datës 20.10.2025, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 21.11.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-69-25 i datës 20.10.2025 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financon projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 3,820.00€ sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 04.09.2025, pagesa për periudhën e muajit nëntor 2025, sipas numrit të zotimit 2025-227694.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Palëve
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalje - Izlazna - Outgoing
02 237-25
Tarih/Dt. 19.11.2025

02 Nr. 237 -25
Me 19.11.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 26 dhe 27 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar nga RDA-AZHR JUG dhe Kryetari i Komunës së Mamushës si dhe lidhur me nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për Caktimin e Koordinatorit të Projektit

I

Z. **Fahri Krüezi**, me anë të këtij vendimi **caktohet Koordinator i Projektit**, në bazë të Memorandumit nr. **02-Nr.69-25**, datë **20.10.2025**.

II

Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Projektit janë të përcaktuara sipas Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Mamushës dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug, nr. **02-Nr.69-24**, datë **20.10.2025**.

III

Koordinatori i Projektit është i obliguar, në përputhje me Memorandumin, të hartojë raport pas çdo pagese të kryer në kuadër të projektit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria e Zhvillimit Ekonimik
2. Z. Fahri Krüezi
3. AZHR-JUG
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalëse - Lëshuar - Outgoing
02 Nr. 236-25
Tarih/Dt. 19.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02Nr. 236-25
Me 19.11.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 63 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, lidhur me nenin 44, 45, 46 dhe 48 të Ligji nr. 05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M
Për transferimin e nëpunëses Civile

Neni 1
znj. Fitore Bytyçi me numër personal 1171198077 nga pozita Zyrtares së Lartë Ligjore në QKMF në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, transferohet në pozitën Zyrtare e Lartë për Burime Njerëzore, në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës.

Neni 2
Vendi i ri i punës është i kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.58 (Klasa GJ32 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3
Nëpunësja fillon punën si Zyrtare e Lartë për Burime Njerëzore nga data 19.11.2025.

Neni 4
Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në Aktemërimin e nëpunëses civile.

Neni 5
Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

Znj. Fitore Bytyçi, e punësuar në vendin e punës Zyrtare e Lartë Ligjore në QKMF në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, transferohet në pozitën Zyrtare e Lartë për Burime Njerëzore në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Mamushës për shkak të interesit të institucionit.

Duke pasur parasysh se znj. Fitore Bytyçi ka përgatitje profesionale të përshtatshme për pozitën në të cilën transferohet dhe se përgatitja e saj është në përputhje me kërkesat e vendit të punës, transferimi vlerësohet i arsyeshëm, ndërsa përvoja e saj si Zyrtare e Lartë Ligjore është marrë si bazë për të siguruar funksionimin efikas në sektorit e Burimeve Njerëzore, sektor i cili aktualisht ka vetëm Udhëheqësen e sektorit.

Ky transferim i mundëson institucionit që të shmangë ngecjet procedurale dhe të sigurojë vazhdimësi pune, si dhe krijon mundësinë që znj. Fitore Bytyçi të zëvendësojë udhëheqësen e njësisë gjatë pushimit vjetor, pushimit mjekësor apo pushimit të lehonisë.

Transferimi i nëpunëses civile realizohet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses civile, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në bazë të nenit 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Transferimi i përhershëm mund të bëhet brenda njësive administrative të të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të shërbimit civil, me kusht që përgatitja profesionale e nëpunësit të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës ku transferohet. Brenda të njëjtit institucion, transferimi bëhet me pajtimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, udhëheqësit më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses civile.

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme dhe e domosdoshme për interesin e institucionit dhe prandaj vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- znj. Fitore Bytyçi;
- DMZP;
- NJMBNJ
- arkivi.

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazno - Outgoing
02 No. 235-25
Tarih/Dt. 13.11.2025

ZYRA E KRYETARIT
02. Nr. 235 -25
Me datë: 13.11.2025
Komuna e Mamushës

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe nenit 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

Për ri-emërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në Pozitën e Drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU"

Neni I

z. Erol Morina caktohet Ushtrues Detyre Drejtor të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "ANADOLU në Komunën e Mamushës për një afat prej tre (3) muajsh, duke filluar nga data 20.11.2025 deri më 20.02.2026.

Neni II

Obligohet Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor të shpallë konkurs të ri për rekrutimin në pozitën e drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU" në Komunën e Mamushës.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ri-emërimi i U.D. Drejtorit është bërë për shkak të përfundimit të kontratës së drejtorit të mëparshëm të shkollës dhe dështimit në konkursin e hapur. Në mungesë të pozitës së Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "ANADOLU", z. Erol Morinës i vazhdon të jetë U.D. Drejtor deri në përfundim të procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit me konkurs.

Vendimi për caktimin e U.D. Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "ANADOLU" pranë Komunës së Mamushës është vazhduar në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.

Emërimi i përkohshëm i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit bëhet nga subjektet përgjegjëse për emërimin me mandat të plotë të kandidatëve për këto pozita, kur vendi i punës shpallet i lirë dhe emërimi i përkohshëm vazhdon deri në përfundimin e procedurave ligjore për përzgjedhje, sipas Rregullores.

Duke marrë parasysh fillimin e vitit shkollor, U.D. Drejtori Erol Morina është duke udhëhequr institucionin shkollor dhe është vlerësuar se duhet të vazhdojë të mbajë këtë pozitë deri në përfundim të procedurave, duke siguruar organizimin e nxënësve, mësimdhënësve dhe funksionimin e rregullt të vitit shkollor 2025/2026.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DKA
- Z. Erol Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No. 02-234-25
Tarih/Dt. 17.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

ZYRA E KRYETARIT
02. Nr. 234-25
Me datë: 17.11. 2025
Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr..03./-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 Udhëzim Administrativ (shëndetsi) nr. 04/2020 Kujdesi Paresor Shendetesor lidhur me nenin 26 dhe 27 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

V E N D I M
Për riemërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë

NENI I

APROVOHET: Kërkesa me numër protokolli 02.Nr.72-25, e datës 17.11.2025, e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës, që në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë të riemërohet z. Mirat Morina si Ushtrues Detyre për një afat prej tre (3) muajsh, nga data 17.11.2025 deri më 17.02.2026.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që, brenda afatit ligjor, të shpallë konkurs për rekrutimin e pozitës së Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës ka parashtruar kërkesë për riemërimin e z. Mirat Morinës si Ushtrues Detyre (U.D.) i Kryeinfermierit të QKMF-së në Mamushë. I njëjti ka qenë i caktuar më herët në këtë detyrë dhe, me kërkesën me nr. protokolli 02.Nr.72-25, të datës 17.11.2025, është kërkuar që t'i riemërohet edhe për një afat prej tre (3) muajsh.

Riemërimi i Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë është bërë për shkak të mungesës së një kryeinfermieri të përhershëm në këtë institucion. Z. Mirat Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DSHMS-së për caktimin si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e procedurave përzgjedhëse për Kryeinfermierin e rregullt.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranë Komunës së Mamushës për riemërimin e Kryeinfermierit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, e njëjta është aprovuar, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës është vazhduar konform Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Duke marrë parasysh rolin dhe funksionimin e QKMF-së, si dhe rolin e Kryeinfermierit në këtë institucion shëndetësor parësor, është vlerësuar se të njëjtit duhet t'i vazhdohet vendimi si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e të gjitha procedurave të konkursit të rregullt dhe publik.

Andaj është vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DSHMS
- Z. Mirat Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazni - Outgoing
02 Nr. 233-25
Tarih/Dt. 17.11.2025

ZYRA E KRYETARIT
02. Nr. 233-25
Me datë: 17.11.2025
Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr..03./-040, Udhëzim Administrativ (shëndetsi) nr. 04/2020 Kujdesi Paresor Shendetesor, lidhur me nenin 26 dhe 27 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

V E N D I M

Për riemërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë

NENI I

APROVOHET: Kërkesa me numër protokolli 02.Nr.72-25, e datës 17.11.2025, e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës, që në pozitën e Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të riemërohet z. Ramadan Mazreku si Ushtrues Detyre edhe për një afat prej (3) muajsh, nga data 17.11.2025 deri më 17.02.2026.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor, të shpallë konkurs për rekrutimin e pozitës së Drejtorit të QKMF-së në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës ka parashtruar kërkesë për riemërimin e z. Ramadan Mazreku si Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së. I njëjti ka qenë i caktuar më parë në këtë pozitë me vendim përkatës, dhe me kërkesën me numër protokolli 02.Nr.72-25, të datës 17.11.2025, është kërkuar që të riemërohet për një afat prej tre (3) muajsh.

Riemërimi i z. Ramadan Mazreku si U.D. Drejtor i QKMF-së është kërkuar për shkak të dështimit të konkursit të hapur me nr. RN00017502. Në mungesë të një drejtori të rregullt të QKMF-së, atij i vazhdohet vendimi, në përputhje me kërkesën e DSHMS-së, për të ushtruar detyrën e drejtorit deri në përfundimin e procedurave përzgjedhëse për këtë pozitë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranë Komunës së Mamushës për riemërimin e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e njëjta është aprovuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e z. Ramadan Mazreku si U.D. Drejtor i QKMF-së është vazhduar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Duke marrë parasysh rolin dhe funksionimin e QKMF-së, si dhe faktin që z. Ramadan Mazreku është duke e udhëhequr me përgjegjësi institucionin parësor shëndetësor, është vlerësuar se duhet të vazhdojë ushtrimin e detyrës së Drejtorit të QKMF-së deri në përfundimin e të gjitha procedurave të konkursit të rregullt dhe publik.

Andaj, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DSHMS
- Z. Ramadan Mazreku
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çiku: Dalëse - Izlazni - Outgoing
02 Nr. 232-25
Datë/Dt. 17.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 232/25
Me 17/11/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01 Nr. 007-19 të datës 28.03.2019, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës merrë këtë:

V E N D I M

Pagesë subvencione për lehona

Neni 1

Në bazë të vendimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmës nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere me numër protokolli 02/Nr.01-25 të datës 08.01.2024 dhe rekomandimit të Komisionit me numër protokolli 02/Nr.71-25 të datës 17.11.2025 lejohen pagesat për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve sipas kërkesave të lehonave

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të mëposhtëm janë në shumën prej 1,900.00 € (njëmijë e nënqind euro) dhe sigurohen nga buxheti i Komunës së Mamushës, nga kategoria ekonomike e subvencioneve.

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Letërnjoftimi	Emri i Bankës	Xhirollogaria Bankare	Shuma €
1	Nazli Morina	1232345302	TEB	[redacted]	100.00
2	Semanur Mazrek	1240044753	RBKO	[redacted]	100.00
3	Ayse Kruezi	1232346449	RBKO	[redacted]	100.00
4	Nazar Mazreku	1245239862	NLB	[redacted]	100.00
5	Aleyna Morina	1243386132	TEB	[redacted]	100.00
6	Adilina Mazrek	1176378618	BKT	[redacted]	100.00
7	Melek Taci	1250084761	RBKO	[redacted]	100.00
8	Aysen Sala	1233874465	BPB	[redacted]	100.00
9	Aylin Taci	1241017504	TEB	[redacted]	100.00
10	Meyrem Kruezi	1242519848	TEB	[redacted]	100.00
11	Rumeysa Butuc	1251065388	TEB	[redacted]	100.00
12	Gonulay Butuc	1232586601	TEB	[redacted]	100.00

13	Sergul Mazreku	1232345167	TEB	[redacted]	100.00
14	Femiyegul Mazrek	1243317246	TEB	[redacted]	100.00
15	Songyl Berisha	1245056253	BPB	[redacted]	100.00
16	Naside Tac	1250706266	TEB	[redacted]	100.00
17	Nurdan Sala	1243185811	TEB	[redacted]	100.00
18	Necmiye Taci	1240243853	BKT	[redacted]	100.00
19	Gulzamir Tac	1232585095	RBKO	[redacted]	100.00
				TOTAL	1,900.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF
- Thesari-MFPT
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 Nr. 231-25
Tarih/Datë 14.11.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS

OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

02 Nr. 231 / 25
Më: 14.11.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: "Furnizimi me Gjenerator dhe pajisje elektrike për pastrimin e dyshemeve për objektet Komunale (Administratë , Arsim dhe Shëndetësi)"-Ritender *me numër të prokurimit:* 626-25-9497-1-2-1 *dhe me nr. të brendshëm* 626-25-009-1-2-1, *emërohet z. Engin Taç, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Erhan Taç.*

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitët para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik , ekipi i menaxhimit te kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;

b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
c. Bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontrtës në sistem të prokurimit elektronik;
g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit te puneve, mallrave dhe sherbimeve
j. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi; dhe
k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimindhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kan të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria eAdministratës,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdülhadi Krasniç
Kryetari i Komunës së Mamushës

_____

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 230-25
Tarih/Dt. 12.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 230/25
Me 12/11/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për pagesën për Sigurimin e Automjetit TPL (Plus +)

Neni 1

Lejohet pagesa për EUROSIG me nr. të fletëpagesës 073422, të datës 10.11.2025, për sigurimin TPL (Plus+) të automjetit me targa 04Z-21-32 dhe me numër të shasisë VR3FBYHZ1RY605938, të markës Peugeot.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë nga kategoria Mallra dhe Shërbime, me përshkrimin Sigurimi i Automjeteve – TPL (Plus +), në shumën prej 41.24 € (dyzet e një euro e njëzet e katër cent), sipas bllokut kodues: 21/626/16314/13951/00000/0133, për përfituesin EUROSIG me nr. unik 811296054, përmes llogarisë bankare BKT: 1901397121031164.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Administratës
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 229-25
Tarih/Dt. 12.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 229/25
Me 12/11/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për pagesën për Sigurimin e Automjetit

Neni 1

Lejohet pagesa për EUROSIG me nr. të fletëpagesës 073421, të datës 10.11.2025, për sigurimin e automjetit me targa 04Z-21-32 dhe me numër të shasisë VR3FBYHZ1RY605938, të markës Peugeot.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë nga kategoria Mallra dhe Shërbime, me përshkrimin Sigurimi i Automjeteve – TPL, në shumën prej 137.47 € (njëqind e tridhjetë e shtatë euro e dyzet e shtatë cent), sipas bllokut kodues: 21/626/16314/13951/00000/0133, për përfituesin EUROSIG me nr. unik 811296054, përmes llogarisë bankare BKT: 1901397121031164.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Administratës
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 228-25
Tarih/Dt. 10.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 228-25
Datë : 10.11.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr-28/2008, neni 25 paragrafi 5 Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët publik, lidhur me neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Rregullores (QRK) NR. 28/2024 Për Pezullimin Nga Marrëdhënia e Punës, si dhe në bazë të neni 45, 46 47 dhe 48 Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative Statutit te Komunës se Mamushes 001/2008 e datës 01.12.2008.

VENDIM
PËR KTHIMIN NË LISTË TË PAGAVE

Neni 1
Neni 1

Nëpunësit Publik, Fikret Morina me numër personal [redacted], , i sistemuar në vendin e punës sipas kontratës Mësimdhënës në "Sh.F.M.U ANADOLU" ka qen kandidat për Kryetar Komune në Komunën e Mamushës, dhe është marrë vendimi për pezullimin e përkohshëm nga vendi i punës pa pagesë, duke filluar nga data 06.09.2025 që është shtatë (7) ditë para hapjes zyrtare të fushatës për zgjedhjet Lokale, deri më datën 14.11.2025, andaj nga data 15.11.2025 pas përfundimit të fushatës zgjedhore i njëjti kthehet në punë dhe në listë të pagave.

Neni 2

Obligohet: Drejtoria e Arsimit në Komunën e Mamushës që të ndërmarrë procedurat e nevojshme për kthimin në listë të pagave nga data 15.11.2025.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe i dërgohet personit të interesuar, si dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore për zbatim.

ARSYETIM

Nëpunësi Publik, Fikret Morina, me numër personal [redacted], pas përfundimit të angazhimit të tij si kandidat në zgjedhjet lokale 2025, dhe në përputhje me rregulloret dhe dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë statusin e nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore, rikthehet në listën e pagave të institucionit duke filluar nga data 15.11.2025.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në përputhje me ligjin, nëpunësi kishte pezulluar përkohësisht ushtrimin e funksionit të tij publik, pa kompensim financiar, për të garantuar paanshmërinë institucionale dhe për të shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi mes funksionit publik dhe angazhimit politik.

Me rikthimin në detyrë dhe në listën e pagave, institucioni siguron vazhdimësinë e marrëdhënies së punës dhe respektimin e plotë të dispozitave ligjore që garantojnë integritetin, profesionalizmin dhe paanshmërinë e shërbimit publik.

Ky veprim është në përputhje me frymën e legjislacionit për administratën publike, me standardet demokratike dhe me parimet e barazisë dhe transparencës në qeverisje.

Me këtë njoftohet

- *Thesari- MFPT*
- *DKA*
- *Arkiva*

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Kraniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës - Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi - Komuna e Mamushës
Opština Mamuša - Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalese - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 227-25
Tarih/Dt. 05.11.2025

02. Nr. 227/25
Me datë: 05.11.2025

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe në bazë të nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës (dhjetor 2008), Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet furnizimi me karburante – naftë, për makineritë e punës të "KFOR-it TURK" në Kosovë, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër protokolli **02-Nr.064/22, të datës 25.07.2022.**

Neni 2

Qëllimi i këtij furnizimi është mundësimi dhe lehtësimi i punëve të hapjes dhe rehabilitimit të rrugëve fushore në territorin e Komunës së Mamushës, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës bujqësore dhe lëvizjes së lirë të fermerëve lokalë.

Neni 3

Furnizimi me karburant do të realizohet përmes operatorit ekonomik me të cilin Komuna e Mamushës ka kontratë për furnizim me karburante, deri në përfundimin e punimeve të hapjes dhe rehabilitimit të rrugëve në zonat fushore të Komunës së Mamushës.

Neni 4

Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që të sigurojë zbatimin e plotë të këtij vendimi dhe mbikëqyrjen e procesit të furnizimit në përputhje me marrëveshjen dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër protokolli **02-Nr.064/22, të datës 25.07.2022**, të nënshkruar ndërmjet **Komunës së Mamushës** dhe **"KFOR-it TURK"**, palët janë

pajtuar për bashkëpunim në realizimin e projekteve infrastrukturore në territorin e Komunës së Mamushës.

Sipas marrëveshjes, **"KFOR-i TURK"** do të angazhojë makineritë dhe pajisjet e veta për hapjen e rrugëve të reja dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese të Komunës së Mamushës, me qëllim të përmirësimit të qasjes për bujqit dhe zhvillimit rural.

Në kuadër të kësaj bashkëpunimi, **Komuna e Mamushës** obligohet të mbështesë punimet përmes **furnizimit me karburant – naftë**, vetëm për makineritë dhe pajisjet e "KFOR-it TURK" që janë të angazhuara në këto aktivitete, deri në përfundimin e plotë të punëve të parapara me marrëveshje.

Vendimi iu dërgohet:

Drejtorisë së Drejtoria e Shërbimeve Publike
Operatorit Ekonomik
KFORIT TURK".
Arkivit.

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 Nr. 226-25
Tarih/Dt. 05.11.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02-Nr. 226/25
Data 05.11.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtar Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, si dhe në bazë të kërkesës me numër të protokollit 97/25 e datës 25.09.2025 nga e punësuara **Z. Veysel Bitiçi**, Raporti nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me numër të protokollit 02.Nr.61/25 e datës 25.09.2025, Kryetari i Komunës merr këtë :

VENDIM
Për pushim pa pagesë

Neni 1
Aprovohet Kërkesa për pushim pa pagesë për **Z. Veysel Bitiçi** nga Mamusha, i Sistemuar në punë dhe në detyrat e punës Mësimdhënës i Teknologjisë Informative në Sh.F.M.U ANADOLU në Komunën e Mamushës, nga data 05.11.2025 deri me datën 05.10.2026 me të drejtë për tu kthyer në vendin e punës para afatit të përcaktuar.

Neni 2
Të lartëpërmendurit në nenin 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas apo para kalimit të afatit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3
Obligohet- Drejtoria Komunale e Arsimit ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), në bazë të këtij vendimi, me qëllim të përditësimit në listën e pagave.

Neni 4
Z. Veysel Bitiçi obligohet që pas apo para përfundimit të pushimit pa pagesë, të rikthehet në vendin e punës në afatin e përcaktuar, në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 5
Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Z. Veysel Bitiçi, nga Komuna e Mamushës, i sistemuar në punë në detyrën e Mësimdhënësit të Teknologjisë Informative në Sh.F.M.U ANADOLU, ka parashtruar kërkesë me nr. protokolli 97/25 e datës 25.09.2025 me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë për periudhën kohore nga 05.11.2025 deri me datën 05.10.2026, me njoftim paraprak tek Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe tek Udhëheqësi më i lartë administrativ.

Kërkesa e lartpërmendur është paraqitur për arsye familjare, respektivisht për shkak të rrethanave të domosdoshme të sipas dokumentacionit të bashkangjitur, lidhur me kujdesin e shtuar ndaj anëtarit të ngushtë të familjes.

Gjatë kësaj periudhe, të punësuarit i pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga marrëdhënia e punës, përveç së drejtës për t'u rikthyer në pozitën e mëparshme pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe administrimit të të gjitha provave, si dhe duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, është konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që zyrtarja publike të shfrytëzojë pushimin pa pagesë për arsye personale.

Andaj, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

- **Z. Veysel Bitiçi**
- DKA
- Njësisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të institucionit

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 225/25
Me 03.11.2025
Mamushë

Republika Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalëse - Outgoing
02 No.Nr. 225-2025
Datë/Dt. 03.11.2025

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

znj. Münever Pala me numër personal: [redacted], e cila sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës gjegjësisht nga Drejtoria e Arsimit me titull të pozitës Mësimdhënës/e Teknologjisë Informative, është përzgjedhur fituese e konkursit në fjalë dhe me datën 03.11.2025 ka nënshkruar kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr./191-25 e datës 03.11.2025 me titull të pozitës Mësimdhënëse e Teknologjisë Informative në "SH.F.M.U ANADOLU"

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Komunale e Arsimit që për të lartcekurën ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të kontratës protokollit 02.Nr./191-25 e datës 03.11.2025, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj.Münever Pala me numër personal: [redacted] ka aplikuar në Konkursin me titull të pozitës Mësimdhënëse e Teknologjisë Informative në "SH.F.M.U ANADOLU" me të cilin është përzgjedhur fituese e konkursit. Andaj, me datën 03.11.2025 ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokollit 02.Nr./191-25 e datës 03.11.2025, me titull të pozitës Mësimdhënëse e Teknologjisë Informative në "SH.F.M.U ANADOLU"

Andaj, bazuar në Ligji nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave, në kuadër Arsimit Fillor sipas bllokut kodues sipas bllokut kodues 10/626/93391/0912 koeficineti 6.60 sipas kodit E19-Cd_222.

Me këtë vendim njoftohet :

- DKA
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazni - Outgoing
No.Nr. 02-224-25
Tarih/Dt. 03.11.2025

02 Nr. 224 /25
Datë 03.11.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

z. Nafiz Kruezi me numër personal: 1[redacted], i cili sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës gjegjësisht nga Drejtoria e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me titull të pozitës Nëpunës Teknik dhe Mbështetës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, është përzgjedhur fituese e konkursit në fjalë dhe me datën 03.11.2025 ka nënshkruar kontratën e punës me numër të protokollit 02.Nr./190-25 e datës 03.11.2025 me titull të pozitës Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare,

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurën ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të kontratës protokollit 02.Nr./190-25 e datës 03.11.2025, kategoria nëpunës teknik dhe mbështetës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Nafiz Kruezi me numër personal: [redacted] ka aplikuar në Konkursin me titull të pozitës Nëpunës Teknik në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me të cilin është përzgjedhur fitues i konkursit. Andaj, me datën 03.11.2025 ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokollit 02.Nr./190-25 e datës 03.11.2025, me titull të pozitës Nëpunës Teknik dhe Mbështetës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare".
Andaj, bazuar në Ligji nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Shëndetësisë
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç